



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:004929

Datë: 09.01.2024

Numri i dokumentit: 05166829

Ep.nr.9/2022

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtarja Blerta Kelmendi, në çështjen juridike përmbareme të kreditorit Kompania Kosovare për F me E. E Sh.A.(K) me seli në P, Bulevardi B.B nr.5, Ndërtesa e, Kati ..., ndaj debitorit S.G, nga fshati B, i komunës së Pejës, me bazë juridike përmbareme pagesa e borxhit në bazë të dokumentit të besueshëm, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit kundër Urdhrit të Përmbaremit Privat Blerim Baloku, me seli në Pejë, P.nr./I.br.373/21 i datës 07.12.2021, jashtë seancës gjyqësore, me datë 09.01.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET PJESËRISHT SI I BAZUAR, prapësimi i debitorit S. G, nga fshati B, i komunës së Pejës, ashtu që SHFUQIZOHET pjesërisht, Urdhri i Përmbaremit Privat Blerim Baloku, me seli në Pejë, P.nr./I.br.373/22 i datës 07.12.2021, sa i përket shumës së borxhit në lartësi prejeuro.

II. REFUZOHET I PABAZUAR, pjesa tjetër e prapësimit të debitorit dhe MBETET NË FUQI Urdhri Përmbaremit, P.nr./I.br.373/22 i datës 07.12.2021, i Përmbaremit Privat Blerim Baloku, me seli në Pejë, sa i përket shumës në vlerë prej 362.30 euro.

A r s y e t i m

Kreditori Kompania Kosovare për Furnizim me E .E Sh.A.(K..) me seli në Prishtinë, Bulevardi B.K nr.5, Ndërtesa e ElektroKosova Kati ..., me datë 07.12.2021, ka parashtruar propozim për lejimin e përmbaremit në bazë të dokumentit të besueshëm ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e furnizimit me energji elektrike për periudhën kohore nga data 28.01.2019 deri me datën 11.11.2021, baza juridike borxh në vlerë prej€.

Duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Përmbaruesi Privat përmes Urdhrit për Përmbarim P.nr./I.br.373/22, të datës 07.12.2021, e ka lejuar përmbarimin e propozuar.

Debitori në afatin e lejuar ligjor, me datën 14.12.2021, ka parashtruar prapësim kundër këtij urdhri përmbarimor, duke u thirrur në parashkrimin e borxhit prej euro gjegjësisht deri me faturën e datës 07.12.2020, nën arsyetimin se kemi të bëjmë me kërkesa të cilat parashkruhen pas një viti, nga dita e arritjes së borxhit për pagesë, ndërsa nga fatura e datës 11.12.2020 borxhi nuk është parashkruar ka vlerën prej 243.08 euro, gjatë kësaj periudhe debitori ka paguar 69 euro dhe si borxh përfundimtar ka mbetur shuma 174.08 euro, të cilën nuk ka mundur ta paguaj për shkak të kushteve të rënda ekonomike, duke i propozuar gjykatës që të shfuqizohet urdhri përmbarimor pjesërisht.

Përfaqësuesi i kreditorit me datën 16.12.2021, ka paraqitur përgjigje në prapësim, me të cilin e ka kundërshtuar prapësimin e ushtruar nga ana e debitorit si të pabazuar dhe të paargumentuar përmes asnjë prove. Sa i përket çështjes së parashkrimit në të cilin është thirr pala debitore në prapësim, kreditori konsideron se ky pretendim nuk qëndron pasi që me datën 07.10.2021, debitori ka bërë pagesë prej 50 euro, të energjisë elektrike, me ç'rast në baza vullnetare nënkuptohet si manifestim i pranimit të borxhit, që shkakton edhe ndërprerjen e parashkrimit sipas nenit 368 të LMD-së, duke i propozuar gjykatës që të refuzohet si i pabazuar prapësimi i debitorit dhe urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata në procedurën përmbarimore pasi ka shqyrtuar dhe vlerësuar prapësimin e palës debitore, përgjigjen në prapësim të dhënë nga pala kreditore, si dhe shkresat e tjera të lëndës, ka gjetur se prapësimi është pjesërisht i bazuar.

Shqyrtimi i ligjshmërisë së urdhrit përmbarimor dhe dokumentit të besueshëm.

Në propozimin për përmbarim të datës 06.12.2021, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Blerim Baloku, me seli në Pejë, P.nr./I.br.373/22 i datës 07.12.2021, në bazë të dokumentit të besueshëm- ekstrakti nga librat afariste, nga ana e kreditorit është kërkuar borxhi për periudhën kohore nga data 28.01.2019 deri me datën 11.11.2021, në shumën prej 718.81 euro, për konsumin e energjisë elektrike.

Gjykata vlerëson se dokumenti i besueshëm-ekstrakti nga librat afariste, mbi bazën e së cilës është filluar procedura përmbarimore, është dokumenti juridik i besueshëm dhe titull i përshtatshëm për përmbarim, dhe si i tillë i plotëson të gjitha kushtet ligjore në kuptim të dispozitës së nenit 29 par.1 pika 1.2 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (tutje LPP-së), që përcakton se: *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.1. kambialet dhe çeket me potest dhe faturë kthyese, po që se janë të nevojshme për themelimin e kërkesës; 1.2. ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”*.

Në këtë drejtim, dokumenti i besueshëm, mbi bazën e së cilës është aprovuar edhe urdhri për përmbarim është i ligjshëm dhe në harmoni me par.3 të nenit 29 të LPP-së, që përcakton se:

“Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmburim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”.

Gjykata pas vlerësimit të ekstraktit gjen se prapësimi i debitorit në drejtim të parashkrimit të kërkesës së kreditorit për arkëtimin e borxhit është pjesërisht i bazuar dhe kreditori për një pjesë të borxhit e ka humbur afatin ligjor brenda të cilit do të mund të kërkonte përmbushjen e detyrimit përmes gjykatës.

Sipas vlerësimit të gjykatës borxhi i krijuar nga ana e debitorit që nga data 28.01.2019 deri me datën 31.12.2019, është parashkruar sepse ka kaluar afati 1 vjeçar brenda së cilës kreditori ka pasur mundësi të kërkoj përmbushjen gjyqësore të detyrimit dhe atë bazuar në nenin 360 par.1 pika 1.1 dhe par.2 dhe 3 të LMD-së i cili që përcakton se: *“Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti: 1.1. kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake; 2. Afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë. 3. Parashkrimi rrjedh edhe nëse furnizimi dhe shërbimet vazhdojnë”.*

Sa i përket rrjedhshmërisë së afatit të parashkrimit, tek kërkesat periodike siç është rasti konkret, afati i parashkrimit fillon të rrjedhë nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë. Si rrjedhojë, për borxhin e vitit 2019 afati ka filluar të rrjedhë në fund të vitit 2019, respektivisht më 31.12.2019, ndërsa i njëjti është parashkruar pas një viti gjegjësisht me 31.12.2020.

Kurse, propozimi për përmburim nga kreditori është paraqitur me 07.12.2021, që në kuptim të nenit 360 par.1 të LMD-së, kreditori për këtë periudhë kohore, propozimin për përmburim e ka paraqitur jashtë afatit ligjor 1 vjeçar, me ç'rast, borxhi i krijuar nga 28.01.2019 e deri më 31.12.2019, në shumë prej 247.51 euro është parashkruar.

Vendosja si në pikën II të dispozitivit të aktvendimit.

Pas parashkrimit të pjesshëm të kërkesës së kreditorit të arsyetuar si më lartë, gjykata konstaton se bazuar në ekstraktin afarist, rezulton se kërkesa e kreditorit për borxhin nga data 01.01.2020 e deri më 11.11.2021, në shumën prej 471.30 euro nuk është parashkruar, kjo për shkak se kreditori me paraqitjen e propozimit për përmburim të datës 07.12.2021 e ka ndërprerë parashkrimin për periudhën e lartëcekur. Parashkrimi i borxhit i vitit 2020 ka filluar të rrjedhë në fund të këtij viti, pra me 31.12.2020 dhe do të parashkruhej pas një vitit respektivisht me 31.12.2021, ndërsa borxhi i vitit 2021 do të parashkruhej me 31.12.2022, kurse kreditori propozimin për përmburim e ka paraqitur me datën 07.12.2021, brenda afatit ligjor 1 vjeçar, i paraparë me nenin 360 par.1 të LMD-së dhe se me paraqitjen e propozimit ka bërë ndërprerjen e parashkrimit në kuptim të nenit 369 par.1 të LMD-së që përcakton se: *“Parashkrimi ndërprehet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarur kundër debitorit para gjykatës ose autoriteti tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës”.*

Në anën tjetër, shumes prej 471.30 euro e cila nuk është parashkruar duhen zbritur shuma prej 109 euro, për shkak se në këtë periudhë kohore debitori kishte bërë disa pagesa të energjisë elektrike.

Gjykata konstaton se në bazë të ekstraktit afarist, në periudhën kohore nga viti 2020 e deri në vitin 2021, debitori kishte bërë pagesë të energjisë elektrike në shumë prej 109 euro. Respektivisht, debitori kishte bërë pagesë me datë 08.01.2020 në shumë prej 40 euro, me datë 07.10.2021, kishte bërë dy pagesa njëren në shumën prej 19 euro dhe tjetrën në shumën prej 50 euro.

Duke marrë për bazë se detyrimi i debitorit për periudhën 01.01.2020 e deri më 11.11.2021 është 471.30 euro, debitori po në këtë periudhë kohore kishte bërë pagesa në shumë prej 109 euro, borxhi i mbetur rezulton të jetë shuma prej 362.30 euro. Gjykata deri tek ky konkludim ka ardhur duke zbatuar dispozitën ligjore nga neni 276 par.1 të LMD-së, që përcakton se “*Detyrimi shuhet kur ai përmbushet si dhe në rastet tjera të përcaktuara me ligj*”.

Për këtë pjesë të detyrimit, gjykata vendosi si në pikën II të dispozitiv të aktvendimit, dhe debitori detyrohet që shumën prej 362.30 euro t’ia paguaj kreditorit.

Pretendimin e kreditorit se pagesa e bërë nga debitori me datën 07.10.2021 në shumën prej 50 Euro, e ka ndërprerë parashkrimin dhe duhet të nënkuptohet si pranim i tërësishëm i borxhit, gjykata i vlerëson si të pabazuar. Gjykata vlerëson se thirrja në nenin 368 par.2 të LMD-së, nuk gjen mbështetje në këtë rast, kjo pasi që debitori për periudhën e kërkuar në propozimin për përmbarim nuk rezulton të ketë bërë pagesa të energjisë elektrike për secilin këste ashtu siç e kërkon dispozita e nenit 368 par.2 të LMD-së.

Për më tepër, sipas nenit 368 të LMD-së, në paragrafët 1 dhe 2, përcaktohet: “*1. Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin; 2. Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit.*”, kështu gjykata e gjen si të pabazuar pretendimin e kreditorit përderisa nuk është vërtetuar se nuk kemi pagesa të kësteve nga ana e debitorit si dhe pasi që një gjë e tillë mund të vjen në shprehje vetëm nëse ka marrëveshje mes kreditorit dhe debitorit për pagesën e borxhit në këste të caktuara, ndërsa çfarëdo pagese e rregullt e bërë nga ana e debitorit nuk e nënkupton pranimin e borxhit të tërësishëm.

Në këtë drejtim, që të konsiderohet se debitori e pranon borxhin e parashkruar, është situatë që e rregullon shprehimisht me nenin 347 par.1 të LMD-së, i cili përcakton se: “*Njohja me shkrim i detyrimit të parashkruar konsiderohet si heqje dorë nga parashkrimi*”. Në rastin konkret, për të konsideruar se debitori ka pranuar në tërësi borxhin e parashkruar duhet që në mënyrë të vullnetshme dhe me shkrim të pranoj dhe njoh detyrimin e parashkruar, e që në rastin konkret një pranim i tillë nga ana e debitorit nuk ka ndodhur, duke u mbështetur në këtë argumentim gjykata ka vendosur si në pikën e parë të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Ndërsa, sa i përket pretendimet të debitorit të paraqitura në prapësim me pamundësinë së pagimit të shumës së borxhit për shkak të kushteve të rënda ekonomike, gjykata i vlerëson si jorelevante për vendosje ndryshe si dhe të pambështetura në asnjë nga shkaqet ligjore për paraqitjen e

prapësimi të përcaktuara me nenin 71 par.1 të LPP-së, pasi që në ekstraktin e nxjerr nga librat afarist është e përcaktuar debitori si konsumator në të cilën në mënyrë të detajuar janë të përcaktuara shuma e detyrimeve të debitorit, koha e arritjes së tyre, pagesat eventuale, të cilat e bëjnë të kërkueshme kredinë e kreditorit.

Gjithashtu gjykata potencon faktin se procedura përmbarimore, është procedurë e atillë që gjykatës nuk i lejohet shqyrtimi i fakteve materiale mirëpo vetëm shqyrtimi nëse dokumenti i besueshëm është titull juridik për fillimin e procedurës përmbarimore dhe nëse urdhri për përmbarim është i ligjshëm në aspektin formal. Parimi i legalitetit rigoroz formal është një ndër parimet bazë në procedurën përmbarimore sipas së cilit gjykata nuk mund të lëshohet në vlefshmërinë materiale të dokumentit juridik apo në përmbajtjen e tij, por vetëm siguron nëse dokumenti juridik i besueshëm përmban kushtet ligjore formale, si përshtatshmërinë dhe përmbarueshmërinë e dokumentit juridik.

Gjykata lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancën gjyqësore dhe atë referuar vendimit të GJEDNJ-së *Saccoccia kundër Austrisë* (Aktgjykim i datës 18 dhjetor 2008), pasi pretendimet e palëve kanë qenë qarta dhe të njëjtat ngërthenin çështje ekskluzivisht ligjore të cilat nuk e kanë bërë të domosdoshme mbajtjen e seancës publike, në ndërlidhje edhe me natyrën jo komplekse e çështjes, gjykata u bazua në nenin 73 paragrafi 1 të LPP-së i cili përcakton se: *“Gjykata mund të vendosë lidhur me prapësimin jashtë seancës gjyqësore. Përgjithësisht gjykata mund të caktojë seancë publike nëse vlerëson se kjo është e domosdoshme për të kuptuar plotësisht validitetin e prapësimi”*.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 29 par. 1 nënpar.2, nënpar.3 dhe par.3 lidhur me nenin 73 dhe nenit 77 par.1 dhe 5 të LPP-së dhe neni 341 par.1, neni 360 par.1 dhe 2, lidhur me nenin 369 të LMD-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL
2022:004929
Ep.nr.9/2022, me datë 09.01.2024.

G j y q t a r j a

Blerta KELMENDI

UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë, Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, përmes kësaj gjykate.